

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**

**GJUHË ITALIANE**

**Për klasën VI**

**Shkup, 2023**

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	Gjuhë italiane
<b>Lloji/ kategoria e lëndës mësimore</b>	Obligative
<b>Klasa</b>	VI (gjashtë)
<b>Temat/fushat në programin mësimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kontaktet e para</i></li> <li>• <i>Rrethi i afërt - Shkolla</i></li> <li>• <i>Kohë e lirë</i></li> </ul>
<b>Numri i orëve</b>	2 orë në javë / 72 orë në vit
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kompjuter, printer, projektor, tabelë, CD/DVD player, tabelë interaktive;</li> <li>• mjete mbikëqyrëse, postera, foto, fotografi, vegla, karta flash, ngjitëse, letër, letër me ngjyra, hamer, gëershërë, ngjitës, ngjyra druri, markera, etj.</li> <li>• libër shkollor, doracak, fjalor, revistë, komike (të shtypura dhe online)...</li> </ul>
<b>Normativi i kuadrit arsimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- studimet e kryera për gjuhë dhe letërsi italiane – drejtimi arsimor, VII/1 ose 240 ECTS;</li> <li>- studimet e kryera për gjuhë dhe letërsi italiane, VII 1 ose 240 EKTC;</li> <li>- studimet e kryera për gjuhë dhe letërsi italiane - drejtim tjetër, me përgatitjen e duhur pedagogjike-psikologjike dhe metodike të fituar në institucionet e akreditua të arsimit të lartë të, VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS;</li> </ul>

## LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e të mësuarit të përcaktuara në programin mësimor çojnë kah përvetësimi i kompetencave të radhës të përfshira me fushën: **Përdorimi i gjuhëve të tjera** nga Standardet kombëtare:

Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është i aftë:	
II-A.12	të kuptoj frazat dhe përdorimin e zakonshëm të fjalorit në lidhje me fushat me rëndësi më të afërt personale (p.sh. informatat bazë personale dhe familjare, blerje, ushqim, shëndet, mjedis);
II-A.14	të lexojë tekste të shkurtra e të thjeshta dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra e të thjeshta në kuadër temave të njohura;
II-A.16	të komunikon në situata të thjeshta dhe rutinore të cilat kërkojnë shkëmbim të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informatave për temat dhe aktivitetet e njohura;
II-A.17	të inicojë dhe të marrë pjesë në biseda të shkurtra për tema të njohura;
II-A.18	të përdor një sërë frazash dhe fjalish për të përshkruar me fjalë të thjeshta familjen dhe njerëzit tjerë, kushtet e jetesës, interesat dhe aktivitetet e përditshme;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjitha zërat dhe grupet e zërit, duke respektuar rregullat për theksim dhe intonacion, ndërkokë që parregullsitë eventuale nuk e pengojnë komunikimin;
II-A.8	të shkruajë fjalët dhe shprehjet me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit;
II-A.9	të respektojë rregullat themelore gramatikore dhe përjashtimet gjatë të shprehurit me shkrim dhe me gojë.
Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:	
II-B.1	mësimi i një gjuhe tjeter lehtëson mësimin e shumë gjuhëve tjera dhe mundëson komunikimin me anëtarë të grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore;
II-B.2	njohja e më shumë gjuhëve lehtëson qasjen në burime që janë të dobishme për zotërimin e lëndëve mësimore / përbajtjeve tjera;
II-B.3	përmes të mësuarit gjuhëve të tjera, zhvillohet interes i respektit për gjuhë dhe kultura të ndryshme,
II-B.4	përmes të mësuarit gjuhëve të tjera zhvillohet respekti për kulturat tjera dhe përmirësohen kompetencat ndërkulturore.

Programi mësimor përfshin dhe kompetencat përkatëse nga fushat e mëposhtme transversale të Standardeve Kombëtare:

**Shkrim-leximi digjital:**

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe është në gjendje të:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre është i nevojshëm përdorimi efektiv i TIK-ut për të zgjidhur një detyrë/problem;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni ka nevojë për të, të gjejë, të zgjedhë dhe të merr të dhëna, informacione dhe përbajtje digitale
IV-A.7	për të komunikuar duhet zgjedhur dhe përdorur veglat e TIK-ut, për ndarje të sigurt të informacionit, për kontakte dhe bashkëpunim me të tjerët në projekte online, në aktivitete sociale ose për nevoja personale.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme - lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim.

#### **Zhvillimi personal dhe social:**

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe është në gjendje të:</i>	
V-A.4	të bëjë një vlerësim të aftësive dhe arritjeve të tij/saj (duke përfshirë anët e forta dhe të dobëta) dhe, në bazë të kësaj, të përcaktojë prioritetet që do të mundësojnë zhvillimin dhe avancimin e tij/saj,
V-A.6	për të vendosur synime për mësimin dhe zhvillimin personal dhe përfundimtare që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre,
V-A.7	të përdorë përvojat e tij përfundimtare që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre,
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të paraqitet në mënyrë të përshtatshme për situatën,
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të përgjigjet siç duhet, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim përfundimtare që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre,
V-A.15	të bashkëpunoj me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tij/tyre,
V-A.17	të kërkoj informatë kthyese dhe mbështetje përfundimtare që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre,
V-A.19	të jep sugjerime, përfundimtare që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre,
V-A.21	të analizon, vlerëson dhe përmirëson mësimin e vet.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij varen në masën më të madhe nga përpjekja që ai/ajo investon dhe nga rezultatet që ai/ajo i arrin,

V-B.7	iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për kryerjen e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme,
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë të kënaqë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka përgjegjësinë për t'u dhënë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre.
V-B.9	kërkimi i informacioneve kthyese dhe pranimi i kritikave konstruktive çon në përparimin personal në nivel individual dhe shoqëror.

#### **Shoqëria dhe kultura demokratike:**

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe është në gjendje të:</i>	
VI-A.2	të analizojë sjelljen e vet për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet,
VI-A.3	të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij, të dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt, edhe kur nuk është dakord,
VI-A.5	për të kuptuar dallimet midis njerëzve mbi çdo bazë (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, orientimi seksual, etj.),
VI-A.6	te vetja dhe të tjerët të njohë praninë e stereotipeve dhe paragjykimeve dhe të kundërshtojë diskriminimin.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.1	nuk guxon të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, orientimi seksual, etj.);
VI-B.3	të drejtat e njeriut janë universale dhe kufijtë e të drejtave të çdo njeriu janë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

#### **Teknika, teknologja dhe sipërmarrsia:**

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe është në gjendje të:</i>	
VII-A.9	për të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave më parë të miratuara dhe me respekt të vazhdueshëm për rolin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të ekipit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VII-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe qëndrimi ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune.

**Shprehja artistike dhe kultura:**

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe është në gjendje të:</i>	
VIII-A.6	identifikon dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave tjera në mjeshtirë e tij/saj të ngushtë dhe më të gjerë dhe të analizon lidhjen dhe ndërvareseinë e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.4	diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme;
VIII-B.5	dallimet ndërmjet kulturave duhet të shihet si mundësi për të mësuar dhe si sfidë për mirëkuptim të ndërsjelltë dhe përparim;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave tjera kontribuon në sigurimin e respektit të kulturës së vet nga të tjerët.

## REZULTATET NGA MËSIMI

<b>Tema: KONTAKTET E PARA</b> Numri i përgjithshëm i orëve: 33	
<b>Rezultatet nga mësimi:</b>	
<p>Nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. kupton kuptimin e shprehjeve të thjeshta që dëgjon ose janë të shkruara në lidhje me të dhënat personale, familjen, interesat, shijet;</li> <li>2. drejtohet, përshëndetet në mënyrën e thjeshtë që eshtë sjellshme dhe joformale;</li> <li>3. kërkon ose jep informacion për veten dhe familjen tij gjatë kontaktit të parë (emri, mosha, profesioni, kombësia);</li> <li>4. parashtron pyetje ose të përgjigjet pyetjeve të thjeshta lidhur me interesat, shijet;</li> <li>5. shkruan fjali të shkurtra dhe të thjeshta në të cilën ai prezanton veten dhe të tjerët.</li> </ol>	
<b>Përbajtjet (dhe nocionet):</b>	<b>Standardet e vlerësimit:</b>
a) Aktet e të folurit: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshëndetjet formale dhe joformale;</li> <li>• Kërkimi ose dhënia e informacioneve për veten dhe tjetrin gjatë kontaktit të parë (emri, mosha, kombësia);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton pyetje të thjeshta nga bashkëbiseduesi lidhur me të dhënat personale, interesat, shijet, familja;</li> <li>• Përshëndetet në mënyrën joformale të thjeshtë dhe të sjellshme;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehja e shijeve dhe interesave;</li> <li>• Falënderimi dhe përgjigjja ndaj falënderimit;</li> <li>• Prezentimi i vvetes dhe i të tjera.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqitet gojarisht, me fjalë dhe fjali të thjeshta;</li> <li>• Prezenton personin nga rrathi i ngushtë, me fjalë dhe fjali të thjeshta;</li> <li>• Flet në mënyrë të thjeshtë për interesat dhe shijet e tij;</li> <li>• Falënderon dhe i përgjigjet falënderimeve gjatë komunikimit verbal;</li> <li>• Përcjell informacione bazë për shokët e klasës dhe për persona të tjera, në gjuhën italiane;</li> <li>• Shkruan fjali të shkurtra dhe të thjeshta për prezentimin e vvetes ose të dikujt tjeter.</li> </ul>
<p>b) Leksione mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Alfabeti;</li> <li>• Të dhënat personale (<i>nome, cognome, soprannome, data e luogo di nascita, nazionalità</i>);</li> <li>• Profesionet (<i>l'impiegato, il medico, il giornalista, l'ingegnere, l'architetto, l'insegnante, il programmatore, la casalinga, il cantante, l'attore</i>);</li> <li>• Shtetet/Kombësitë (<i>la Macedonia del Nord, l'Italia, la Francia, l'America, l'Inghilterra, italiano, macedone, francese, americano, inglese</i>);</li> <li>• Interesat, shijet (<i>gli interessi, i passatempi, le preferenze, il cinema, lo sport, la musica, il computer, i videogiochi</i>);</li> <li>• Familja (<i>la famiglia, il padre, la madre, il figlio, la figlia, la sorella, il fratello, il nonno, la nonna, lo zio, la zia</i>);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqipton shkronjat e alfabetit italian;</li> <li>• Përsëritja e fjalëve të njohura;</li> <li>• Kupton fjalë dhe shprehje që lidhen me të dhënat personale, interesat, shijet, familja;</li> <li>• Numëron deri 20;</li> <li>• Numëron shtete dhe kombësi;</li> <li>• Emërton aktivitete që lidhen me interesat dhe shijet;</li> <li>• Përdor terma dhe shprehje në fjalitë gjatë prezantimit të vvetes dhe të tjeterit.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>Numrat prej 1 deri 20 (uno, due, tre ...).</li> </ul>	
<p>c) Përbajtjet gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fonetika</li> <li>Ritmi, intonacioni dhe theksi - Ritmo, intonazione e accento (Siete liberi oggi? Sì, siamo liberi tutto il giorno. Apri la porta! Parlare, città, abito).</li> <li>Morfologjia <ul style="list-style-type: none"> <li>Nyja, gjinia dhe numri - Articolo, genere e numero</li> <li>I caktuar/determinativo (il libro/i libri ; la casa/le case);</li> <li>I pacaktuar/indeterminativo (un libro; una casa).</li> <li>Emrat, gjinia dhe numri - Sostantivi, genere e numero (il libro, il cane, la casa, la chiave; il ragazzo/ la ragazza, il figlio/ la figlia; il ragazzo/i ragazzi, la ragazza/le ragazze, il cane/i cani, la classe/le classi).</li> <li>Mbiemrat, gjinia dhe numri - Aggettivi, genere e numero</li> <li>pronor/possessivi (Il mio amico Pino è italiano. La mia macchina è rossa. Vi presento i miei amici americani.).</li> <li>Numrat - Numeri</li> <li>Numrat kryesor /cardinali da 1 a 20 (Gianni compie nove anni. Una settimana ha sette giorni.).</li> <li>Folje - Verbo</li> <li>koha e tashme e foljeve ndihmëse <i>essere, avere</i> - indicativo presente dei verbi ausiliari <i>essere, avere</i>; (Heinz è tedesco. Loro sono italiani. Marco ha due amici.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sipas intonacionit dallon fjalinë pyetëse nga dëftore;</li> <li>I shkruan drejt fjalët dhe shprehjet e sapopërfituar;</li> <li>Për t'u kuptuar, shprehet me fjali mjaft të sakta;</li> <li>Dallon përdorimin e nyjës së shquar nga ajo e pashquar;</li> <li>Përdor mbiemrat pronorë në kontekst të caktuar;</li> <li>Përdor mjetet më të zakonshme për prezantimin e ndonjë personi;</li> <li>Njeh dhe përdor trajtat e foljeve më të zakonshme të grupit të parë në kohën e tashme;</li> <li>Njeh ndajfoljet dhe parafjalët më të zakonshme dhe i përdor në fjali të thjeshta;</li> <li>Përdor një formë mohuese të një rrëfimi të dhënë.</li> </ul>

<p>Loro <i>hanno</i> una nuova casa.);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- format e foljeve më të shpeshta grupit të parë-<i>are</i> në kohën e tashme dëftore: guardare, studiare, parlare (Francesca <i>abita</i> a Milano. Pietro <i>ama</i> cantare.).</li> <li>○ Ndajfoljet- Avverbi</li> <li>- për mënyrën/di modo: bene, male (Elena parla <i>bene</i> il francese.);</li> <li>- për sasinë/di intensità: molto, poco (Mi piace <i>molto</i> la musica italiana.).</li> <li>○ Parafjalët-Preposizioni: in, a, di, con, per (Ogni giorno vado <i>in</i> biblioteca <i>per</i> studiare. Vado <i>a</i> Roma <i>per</i> le vacanze. Questo è lo zaino <i>di</i> Roberto.).</li> <li>● Sintaksa-Sintassi</li> <li>○ Fjalia/Proposizione</li> <li>- dëftore: forma pohore dhe forma mohore (forma affermativa e forma negativa) (Giuseppe <i>ama</i> il calcio. Elena <i>non ama</i> il calcio.);</li> <li>- pyetëse: proposizione interrogativa (Chi è questo ragazzo? Come si chiama?).</li> </ul>	
<p>ç) Përbajtje për diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Përshtendetje në kulturën e vet dhe në Itali;</li> <li>● Paraqitura e sjellshme;</li> <li>● Monumente, specialitete dhe personalitete të njohura të Italisë;</li> <li>● Emrat tipikë personalë të Italisë;</li> <li>● Fjalë të njohura të pranishme në disa gjuhë (internacionalizma).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përdor shprehje të përshtatshme për përshtendetje dhe paraqitje, në gjuhën italiane (me moshatarët dhe të rriturit);</li> <li>● Dallon/krahason akte të thjeshta komunikuese (paraqitje të sjellshme dhe joformale) në Maqedoni dhe në Itali;</li> <li>● Numëron monumente, specialitete dhe personalitete të njohura të Italisë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numëron emrat e bashkëmoshatarëve të tij nga Italia;</li> <li>Përdor fjalë të pranishme në disa gjuhë (internacionalizma).</li> </ul>
--	--

**Shembuj të aktiviteteve:**

(Një pjesë e shembujve bashkojnë më shumë standarde vlerësimi nga përbajtja e njëjtë që mund të zbatohen në disa orë mësimore.

Shembujt e dhënë mund të shërbejnë edhe si model për krijimin e aktiviteteve të reja për të njëjtat standarde ose të tjera që nuk janë përfshirë prej tyre.)

- Shqiptimi i shkronjave të alfabetit italian. Nxënësit dëgjojnë këngë me alfabetin italian, vëzhgojnë një poster me shkronja dhe ushtrojnë shqiptimin e shkronjave.
- Ushtrime për përvetësimin e theksit, ritmit dhe intonacionit karakteristik për gjuhën italiane. p.sh. *Matteo è italiano*. Matteo është italian?
- Dëgjimi i audio inçizimi dhe përsëritja e shprehjes së dëgjuar.
- Shqiptimi i fjalëve. Mësuesi u shpërndan nxënësve fleta letre me fjalë të njobura, të cilat mund të përsëriten në varësi nga numri i nxënësve. (*aereo, moda, telefono, caffè, taxi, Internet, ciao*). Secili nxënës tërhjek një fletë letre, e shqipton fjalën dhe pjesa tjetër e nxënësve dëgjojnë me kujdes dhe ngrenë dorën e majtë për shqiptimin e saktë dhe dorën e djathtë për shqiptimin e gabuar.
- Dëgjimi, dallimi dhe shqiptimi i zërave. p.sh. nxënësit dëgjojnë fjalët dhe ngrenë dorën kur dëgjojnë fjalën me zërin e kërkuar, nxënësit dëgjojnë fjalët dhe i përsërisin ato.
- Ushtrime për dhënien e supozimeve, nxjerrjen e përfundimeve në bazë të tituve, fotografiave, sinjaleve zanore.
- Plotësimi i vendeve boshe në tekste, tabela dhe fjalë me leksione mësimore dhe përbajtje gramatikore adekuate. Shembull:*Ciao, io sono Alice. Siete americani? Sì, noi siamo americani*.
- Renditja në dialog fjalitë e dhëna në mënyrë të përzier.
- Ciao Maria!*. Nxënësit dëgjojnë një dialog dhe plotësojnë vendet boshe në fjalë me shprehje që nënkupton përshëndetjet.
- Come ti chiami?*. Nxënësit në dyshe i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe u përgjigjen pyetjeve të parashtruara. Nxënësit tjerë dëgjojnë, nëse është e nevojshme e përmirësojnë përgjigjen si dhe strukturën e fjalisë.
- Di dove sei?*. Nxënësit dëgjojnë dy dialogë të shkurtër, shënojnë në fletore kombësítë që dëgjojnë dhe më pas i thonë.
- Kartëvizita*. Nxënësit krijojnë kartëvizita me të dhëna fiktive, më pas në dyshe luajnë role, bëjnë pyetje (*Come ti chiami, Quanti anni hai? Dove abiti?...*) dhe u përgjigjen atyre.
- Bingo*. Nxënësit shkruajnë në një fletë letre pesë fjalë që tregonjë një profesion. Mësuesi nxjerr nga kutia një nga një letrat të përgatitura paraprakisht me fjalë që tregonjë një profesion, e tregon dhe lexon me zë të lartë dhe nxënësit rrethojnë ato fjalë që përputhen me fjalët e dëgjuara nga mësuesi. Fitues është nxënësi që ka rrëthuar më shumë fjalë.
- I domino dei verbi*. Mësuesi u shpërndan nxënësve fleta letre avere или essere, në formën e lojës domino, në këndin e djathtë të çdo flete shkruhet përemri vetor dhe folja e ndryshuar në vetën e caktuar, ndërsa në anën e majtë folja. Loja mund të jetë në çifte ose

grupe.

- *Lojë me kube.* Në njerën cube janë anëtarët e familjes ndërsa në të tjetrën janë mbiemrat pronorë (tre mbiemra në njérën anë të kubes për të zgjedhur formën e rregullt, p.sh. *mio, tuo, sua*). Nxënësit hedhin kubet dhe përpilojnë fjali të tipit: Chi è questo? - E' mio fratello.
- *Porosi nga Italia* (punë në dyshe): Një nxënës merr një porosi nga shoku i tij/saj nga Italia me informacion bazë për të (emri, mosha, shijet, familja). Shoku i tij/saj i klasës, i cili nuk e kupton tekstin, dëshiron të dijë më shumë për shokun/shoqen nga Italia. Nxënësit në dyshe, luajnë role, njëri nxënës i parashtron pyetje tjeterit (në gjuhën amtare) në mënyrë që të marrin më shumë informacion nga porosia për djalin/vajzën.
- *Il puzzle degli interessi.* Prerje e fletëve dhe në secilën fletë në pjesën e përparme ka një fotografi me aktivitetet ndërsa në anën e pasme është shkruar fjala e aktivitetit. Nxënësit sipas aktiviteteve bëjnë lojë me bashkim pjesësh të fjalive dhe më pas e pëershkruanë atë.
- *Quiz coni verbi ausiliari.* Nxënësve, në dyshe ose në grupe, marrin fletët e tekstit të cilat duhet të fusin foljet essere dhe avere. Për çdo përgjigje të saktë në tabelë shënohet një pikë. Dyshja ose grupi me më shumë pikë është fituesi.
- *Giocare con i numeri.* Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grupi i shpërndahen letra me numra. Nxënësit duhet të shkruajnë numrat me fjalë. Secili grup shkon del në tabelë dhe shkruan përgjigjet e sakta. Fitues është grupi që i ka shkruar numrat e saktë.
- *La ruota della fortuna.* Në fletë letre vizatohet një rrotë në formën e orës me një shigjetë në të cilën janë shkruar numrat nga 1 deri në 20. Nxënësit e kthejnë shigjetën dhe në cilin numër ndalon shigjetat, nxënësit e shkruajnë atë numër në tabelë.
- Përpilimi i fjalëve të thjeshta nga shkronjat e dhëna në rend të përzier. p.sh. *ASAC-CASA ; RENTO-TRENO*.
- Klasifikimi i fjalëve. Nxënësit nënvízojnë në tekst emrat që mbarojnë me -a dhe -o (duke bërë dallimin mes gjinisë mashkullore dhe femërore) dhe më pas i renditin në tabela përkatëse.
- Emërtimi i nocioneve sipas paraqitjeve vizuale (karta flash, ilustrime, foto nga revista).
- *Telefon i shurdhër.* Nxënësit vazhdojnë fjalinë që kanënisur dhe pasi e plotësojnë e shkruajnë në tabelë.  
*Paolo è...      Paolo è un...      Paolo è un ragazzo...      Paolo è un ragazzo italiano.*
- *Fjalitë në trajtën mohore.* Nxënësit përpilojnë fjali të shkurtra në trajtën pohuese në copat e letrave e prera dhe i vendosin në një kuti. Më pas secili nxënës tërhek një copë letre dhe thotë ose e shkruan në tabelë fjalinë në trajtën mohore.
- *Luan me role.* Nxënësit, në dyshe, përpilojnë dialogje të shkurtëra në lidhje me të dhënat personale të njerëzve me famë, pa përmendur emrin. Më pas, i luajnë me role. Të tjerët me vëmendje dëgjojnë dhe qëllojnë se për cilin person bëhet fjalë. Fituesi është çifti me më shumë pikë.
- Dëgjim/lexim me kuptim një teksti të thjeshtë dhe përgjigje të pyetjeve të tipit: Chi? Che cosa? Quando? Come? Dove? Perche'? e vërtetë/e gabuar (vero/falso), pyetje të hapura ose pyetje me shumë zgjedhje (QCM)

*Ciao, io mi chiamo Paola e ho dieci anni. La mia famiglia è grande, ho due fratelli, una sorella e un cane. Siamo italiani. Abitiamo a*

*Roma con i nostri genitori e i nostri nonni. Io amo la musica e preferisco cantare le canzoni di Laura Pausini. I miei fratelli preferiscono lo sport, loro giocano a calcio. Mia sorella preferisce giocare a pallacanestro.*

- Shprehje gojore:

*-Buongiorno, mi chiamo Lina, sono della Macedonia del Nord, ho 11 anni. Studio l'inglese e l'italiano.*

*-Ciao, mi chiamo Stella, abito a Skopje, ho 12 anni. Sono macedone.*

- Ndërveprimi gojor:

*-Ciao, io mi chiamo Maria, e tu?- Io sono Sara. -Piacere.*

*-Quanti anni hai? - Ho 11 anni.*

*-Dove abiti? - Abito a Milano, in Italia.*

*-Di che nazionalità sei? - Sono italiano, a.*

*-Qual è il tuo numero di telefono? - Il mio numero di telefono è ..... .*

- Shprehje me shkrim. Nxënësit shkruajnë fjali të thjeshta dhe të shkurtra në të cilat prezantohen.

- I pavarur ose në grup bëjnë një poster me foto, sipas një teme të dhënë, p.sh.*Italia è il paese di.... (monumente historike, specialitete, njerëz të famshëm,...)*

- Kuiz duke përdorur vegla digitale.

- Detyrë projektuese - Pema familjare nga fotografitë. Nxënësit bëjnë një pemë familjare në fleta të formatit A4 për familjen e tyre dhe ua prezantojnë shokëve të klasës.

- Detyrë projektuese - Krijimi i almanakut të nxënësve - Çdo nxënës përgatit një fletë në shtëpi (me foton e tij) dhe një tekst të shkurtër në të cilin prezantohet (emri, mosha, adresa, familja, shijet, personi i preferuar...). Në klasë i bashkojnë punimet e të gjithë nxënësve në një almanak. Së bashku sajognë titullin e faqes.

Tema: **DREJTPËRDREJT ME MJEDISIN - SHKOLLA**

Numri i përgjithshëm i orëve: 24

**Rezultatet nga mësimi:**

Nxënësi do të jetë në gjendje të:

1. kupton dhe jep udhëzime gjatë aktiviteteve të përditshme të nxënësve;
2. të kuptojë në mënyrë globale, të përshkruar klasën në detaje nëpërmjet shprehjeve të shkurtra të dëgjuara dhe të shkruara;
3. pyet/përgjigjet sa është ora;
4. në mënyrë të thjeshtë përshkruan klasën, mjetet shkollore dhe aktivitetet.

Përbajtjet (dhe nocionet):	Standardet e vlerësimit:
<p>a) Aktet e të folurit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dhënia e udhëzime të thjeshta shokëve të klasës gjatë aktiviteteve të përditshme të nxënësve;</li> <li>• Përshkrimi i klasës, mjeteve shkollore dhe aktiviteteve shkollore;</li> <li>• Shprehja e afiniteteve për lëndët mësimore;</li> <li>• Shprehja e orës në mënyrë formale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton dhe reagon udhëzimeve të thjeshta të mësuesit;</li> <li>• Transmeton udhëzime të thjeshta nga mësuesi te shokët e klasës në gjuhën e amtare;</li> <li>• U jep udhëzime të thjeshta verbale shokëve të klasës gjatë aktiviteteve të përditshme</li> <li>• Shpreh me fjali të thjeshta afinitetet e tij për lëndët mësimore;</li> <li>• Flet në mënyrë të thjeshtë për mjetet e tij shkollore dhe lëndët mësimore;</li> <li>• Përshkruan gojarisht, në mënyrën e thjeshtë, aktivitetet e klasës dhe të shkollës;</li> <li>• Pyet dhe tregon sa është ora</li> <li>• Prezanton në gjuhën italiane orarin e paraleles së tij</li> <li>• Shkruan fjali të shkurtra dhe të thjeshta që përshkruajnë klasën, mjetet shkollore dhe aktivitetet shkollore.</li> </ul>
<p>b) Leksione mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkolla, klasa, mjete shkollore (<i>la scuola, la classe, la lavagna, la sedia, il banco, il cestino, il gesso, l'astuccio, lo zaino, il righello, il libro, la gomma, il quaderno, la matita</i>);</li> <li>• Lëndët mësimore (<i>la matematica, le scienze, la geografia, l'informatica, la chimica, la fisica, l'italiano, il francese, l'inglese, la storia, il disegno, l'educazione fisica, la musica</i>);</li> <li>• Orari i orëve (<i>l'orario delle lezioni</i>);</li> <li>• Ditët e javës (<i>lunedì, martedì, mercoledì, giovedì, venerdì, sabato, domenica</i>);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh fjalët dhe shprehjet që lidhen me shkollën;</li> <li>• Kupton fjalët dhe shprehjet që lidhen me shkollën;</li> <li>• Numëron deri 60;</li> <li>• Numëron lëndët mësimore, mjetet në klasë dhe pajisjet shkollore;</li> <li>• Numëron ditët e javës dhe pjesët e ditës;</li> <li>• Kupton termat që tregojnë ngjyrat kryesore;</li> <li>• Emëron ngjyrat kryesore;</li> <li>• Përdor terma dhe shprehje, me fjali të thjeshta, që lidhen me shkollën;</li> <li>• Përdor fjalë dhe shprehje të përshtatshme për të treguar orën.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesët e ditës (<i>il mattino, il mezzogiorno, il pomeriggio, la sera, la notte, la mezzanotte</i>);</li> <li>• Ngjyrat (<i>bianco, nero, rosso, verde, azzurro, blu, giallo, marrone</i>);</li> <li>• Numrat <ul style="list-style-type: none"> <li>- kryesor(cardinali) : 1-60;</li> </ul> </li> <li>• Shprehje për të treguar orën (<i>Che ore sono/ Che ora è? - Sono le..../ È l'una e.....</i>).</li> </ul>	
